REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN
SKUPŠTINA LIPLJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	05.05.2021
Referencë:	ZR
Për:	Imri Ahmeti- Kryetar i Komunës
Kopje:	Fauz Xhemajli – Nënkryetar i Komunës Lulzim Qerimi – Nënkryetar i Komunës
Nga:	Emina Rexhiq – Drejtoreshë e DPUMM
Lënda:	**RAPORT MUJOR I PUNËS**

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat dhe obligimet gjatë procesit të punës dhe aktivitetet e përgjithme të zhvilluara në kuadër të Drejtoratit prezenton:

RAPORTI I PUNËS
PËR PERIUDHËN RAPORTUESE
01.04.2021-30.04.2021

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM ka zhvilluar aktivitetet si:

- Dokumenti HZK, është plotësuar sipas komenteve nga MEA , dhe është dorëzuar për shqyrtim në MEA.
- Programi komunal 3 vjeqar për banim, I finalizuar dhe pergaditjet për shqyrtim publik.
- DPUMM ka prezentuar propozim Vendimin per lokacionet për vendosjen e 3 busteve/shtatoreve ne kuader te qytetit te Lipjanit, pas vërejtjeve të dhëna nga MAPL dhe eshte miratuar vendimi nga KK.
- Pjesemarrja ne Komision per shpronësimin e rrugeve: Afrim ZHitia", Mbreti Zog" dhe "Kongresi I Blinajës" ne Lipjan finalizuar –Propozim Vendimi .
- Eshte realizuar takim konsultativ me Kompaninë Cacttus dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim lidhur me finalizimin e te dhënave për për sistemin e menaxhimit te lejeve ndertimore , Programi i BB.
- Bashkëpunim me Drejtoratet relevante rreth finalizimit të të dhënave për sistemin e menaxhimit të përformancës komunale /2020, në proces final te kompletimit t dhenave nga DPUMM.
- Takim konsultativ me përfaqësues nga Organizata EcoZ e cila ne bashkepunim me Organizatën ndërkombetare WWF Adria është duke implementuar një projekt për menaxhimin e integruar te burimeve ujore në Kosovë.
- Eshtë realizuar Takim senzibilizues dhe informues me nxënësit e shkollave fillore me rastin e 22 prillit Dita ndërkombëtare e tokës.

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar lëndët si kërkesat e pranuara dhe kerkesat e bartura, janë pranuar gjithsejt 67 kërkesa dhe lëndët e bartuara gjithësejt 76 lëndë që rezulton në total 143 lëndë , prej tyre janë trajtuar gjithsejt 46 kërkesa, prej tyre të miratuara 29 kërkesa, të refuzuara 12 kërkesa, të bartuar në sektorë tjerë 5 kërkesa .
Gjate kësaj periudhe janë realizuar të hyra në vlerë prej 52,410.56€.

Në procedurë të shqyrtimit janë gjithsejt 97 lëndë, të prezentuara në pjesën tabelare, si vijon:
61 .....Certifikate legalizimi
8.....Kushte ndertimore
13..... Leje ndërtimi
2 ……..Leje rrënimi
1……LMK
5 …….Certifikatë përdorimi
7 …….Kërkesa tjera .

STATISTIKAT

Pranimi dhe Shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Nr.	Llojet e kërkesave	Nr i kërkesave te pranuara gjatë muajit shkurt	Nr. I kërkesave nga periudha e kaluar	Të Pezulluara	Miratuara	Refuzuara	Të bartura në sektor tjera	Në procedurë
1	Kushte ndërtimore	11	13	-	9	6	1	8
2	Leje ndërtimi/renovimi, vendosje e ob. te perkohshme	6	13	-	2	4	-	13
3	Leje rrënimi	2	1	-	1	-	-	2
4	Certifikatë perdorimi	-	7	-		2	-	5
5	LMK	2	-	-	1	-	-	1
6	Certifikate legalizimi /Leje Legalizimi	28	41	-	4	-	-	61
	Ne liste te pritjes				4			
7	Kërkesa të tjera	18	1	-	8	-	4	7
	Gjithsejt	**67**	**76**	**-**	**29**	**12**	**5**	**97**

SFIDAT

Procesi I finalizimit te HZK dhe shqyrtimi I lëndëve.
Procesi I legalizimit /Kategoria II
Situata e Pandemisë.

REKOMANDIME

Trajtimi i kërkesave për Legalizim Kategoria II – krijimi i strukturës organizative.